



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIM**

**PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 09 PARAQITUR NË  
KQZ NË DATËN 28.05.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 28.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKTI:** Për mospranimin për shqyrtim kërkesës ankimore Nr.09, datë 28.05.2019, të paraqitur nga subjekti ankues Partia Ora e Shqipërisë me objekt: Kundërshtimi i vendimit nr.22, datë 21.05.2019 të KZAZ-së nr.17 Klos "Per mosrregjistrimin e listes shumememore per keshillin e bashkise Klos;

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", neni 129, pika 1, 3, germa "b" dhe nenin 130 germa "c" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N:**

Subjekti zgjedhor Partia Ora e Shqipërisë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në Regjistrin e Ankimeve Zgjedhore, me nr.09 regj, datë 28.05.2019.



**Nr. 722 i Vendimit**

**Data 28.05.2019**

**Ora 19:00 e Vendimit**

Për mos pranimin për shqyrtim të kërkesave ankimore nr. 09 të paraqitur në KQZ në datën  
28.05.2019

Në mbledhjen e datës 28.05.2019, ora 19:00 pas relativitetit të znj Rezarta Bitri, dhe diskutimit të përfaqësuesve të partive politike kërkesa nr. 09 u konstatua se kërkesa ankimore nuk i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 dhe në mbështetje të nenit 129 pika 3, germa "b", të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Kërkesa Ankimore nuk duhet të pranohet.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 129, pika 1, 3, germa "b" dhe nenin 130 germa "c" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.09, datë 28.05.2019, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Ora e Shqipërisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>

